



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 26/05/2022 Ref.: 679/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13 dhe 23.05.2022, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji AAB dega në Gjakovë në nivel institucional, për periudhën pesë vjeçare I tetor 2022 – 30 shtator 2027.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji AAB dega në Gjakovë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim në nivel institucional. AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB dega në Gjakovë me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Vizita është organizuar më 04.02.2022, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Peeter Normak dhe Christoph Back.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Nga njëmbëdhjet (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji AAB dega në Gjakovë, është vlerësuar se përmbushë: plotësisht tetë (8) dhe substancialisht tre (3).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen 99 të mbajtur më 13 dhe 23.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit AAB dega në Gjakovë, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë

të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandim: Institucioni obligohet që në periudhën prej gjashtë muajsh të krijojë Qendrën e Këshillimit për Karrierë dhe Punësim, veçmas nga kampusi kryesor dhe të realizojë marrëveshje me industrinë që janë relevante për degën.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB, dega në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

